

## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.02.2019 dhe të rikonfirmimit të datës 27.02.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "PRO&CO GROUP" për aktivitetin: "Ndërtimi i infrastrukturës në disa rrugë të fshati Hajvali dhe të fshatit Mramor në Prishtinë" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-8676-511 nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "PRO&CO GROUP" e datës 25.02.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në disa rrugë të fshati Hajvali dhe të fshatit Mramor në Prishtinë" dhe me Nr.616 18 8676 521, Nr. Brendshëm 616 18 133 511 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 20.02.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 20.02.2019;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "PRO&CO GROUP SHPK" me datë 25.02.2019 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i infrastrukturës në disa rrugë të fshati Hajvali dhe të fshatit Mramor në Prishtinë" me Nr.616 18 8676 511 Nr. Brendshëm 616 18 133 511".

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.02.2018 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


Pretendimi kryesor i ankuesit ka qenë se ka dorëzuar sigurimin e tenderit në Platformën elektronike dhe se është eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet. Lidhur me këtë pretenduesi ka qenë në çasje zyrtare dhe ka verifikuar edhe vetë se në E-prokurim në folderin e paraqitur sigurimi i ofertes, qarkullimi bankar nuk ka të ngarkuar asnjë dokument. Lidhur me këtë i kemi

preferuar ti drejtohet per ndihmë Help deskut të KRPP-së.Pasiqë në ndërkohë nuk kemi marrë asnjë sqarim lidhur me konstatimin nga Helpdesku,kemi përgatitur një shkresë dhe kemi kërkuar që ta sqarojnë këtë rast.Bazuar në shkresën tonë nga Helpdesku kemi pranuar pergjegjen qe i njejt i ua ka derguar ju e sipas të cilës rrjedh se ju keni ngarkuar vetëm folderin me titull:Sigurimi i ofertës,qarkullimi bankar,por në te nuk ka të ngarkuar asnjë dokument. Kapaciteti i folderit është gjithsejt 98 b,i cili kapacitet është krijuar nga emri i folderit dhe nga kompresimi dhe nuk ka asnjë dokument në te njejtin.qe d.t.th.se ai folder është i zbrazët siqë e kemi konstatuar edhe ne ne Njoftimin për refuzimin e tenderit tuaj.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar edhe në konstatimet e Helpdeskut se ai folder është i zbrazët,konstaton se ju nuk keni arrijtur të dorëzoni sigurimin e ofertës siqë kërkohet me dispoziata ligjore dhe ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit